



01/Nr. 9959 /2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40 , 73, Udhëzimit Administrativ Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna neni 8, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 41, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit shpall:

## K o n k u r s

**Për anëtarë në Komitetin Konsultativ të Komunës së Hanit të Elezit**

- Komiteti për Personat me Aftësi të Kufizuara, pesë (5) anëtarë.

### Kriteret:

- Anëtarët e Komitetit konsultativ përbëhen nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të cilët duhet të jenë njohës të fushave përkatëse .
- Përfaqësimi gjinor në Komitetin Konsultativ duhet të jetë sipas legjislacionit në fuqi.
- Kandidatët për anëtar në Komitetin Konsultativ duhet të jenë banor të Komunës së Hanit të Elezit.
- Përgatitja profesionale është përparësi.

**Dokumentet e kërkuara:** CV, Diploma e Fakultetit apo e Shkollës së Mesme, Certifikata e lindjes, Kopje e letërnjoftimit, Certifikata e vendbanimit.

Kandidatët të cilët do të konkurojnë do t'i nënshtrohen intervistimit.

Afati për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara është 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetat publike.

Dokumentet e pa kompletuara dhe ato që arrijnë pas kësaj date nuk do të shqyrtohen .

**Mandati:** Mandati i anëtarëve të Komitetit Konsultativ është katër (4) vjeçar. Anëtarët e Komitetit Konsultativ nuk mund të shërbejnë më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme si anëtarë të atyre komiteteve.

**Kompensimi:** Për punën e tyre në Komitetet Konsultative, anëtarët e këtij komiteti do të kompensohen në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme.

### Kompetencat e Komitetit Konsultativ:

- Japin propozime për rregullore të ndryshme,
- Paraqesin propozime për hulumtime të ndryshme.
- Japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, Komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushat përkatëse.
- Paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve të Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës.
- Japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

Hani i Elezit  
Data: 06.11.2019



Kryesuesi i Kuvendit  
MS. Qamush Brava